



# MANUALI I PËRDORIMIT

## eKrum-Mobile

# Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Krijimi i llogarisë	4
2.1. Aktivizimi i llogarisë	5
3. Kycja në sistem	7
4. Fjalëkalimi i harruar	8
5. Shtimi i pronave	9
6. Ballina e sistemit	10
6.1. Grafiku i Përdorimit dhe Kostos	11
6.2. Tabela e Transaksioneve	12
6.2.1. Detajet e Transaksioneve	13
6.3. Transaksionet – Faturat	14
6.4. Transaksionet – Pagesat	15
7. Menuja e Transaksioneve	16
7.1. Transaksionet	17

8. Pagesa Online	18
8.1. Zgjedhja e Shumës për pagesë	19
8.2. Procesi i verifikimit të llogarisë bankare	20
9. Njoftimet	21
9.1. Faqja e Njoftimeve	22
10. Cilësimet	23
10.1. Ballina e Cilësimeve	24
10.2. Gjuha	25
10.3. Profili	26
10.4. Ndrysho Fjalëkalimin	27
10.5. Menaxho Pronat	28
10.6. Çkyçja nga sistemi	29


# 1. Hyrje

- Përdoruesi duhet të qaset në sistem përmes një telefoni mobil me sistem operativ **iOS** ose **Android**.
- Nëse aplikacioni nuk është i instaluar, përdoruesi duhet ta shkarkojë aplikacionin përmes:
  - [Google Play Store](#) (për Android)
  - [App Store](#) (për iOS)
- Pas instalimit, hapet aplikacioni i sistemit në telefon.
- Pas hapjes së aplikacionit, shfaqet **faqja e kyçjes**.



## 2. Krijimi i llogarisë

- Hapni aplikacionin në telefonin tuaj.
- Në ekranin fillestar klikoni (“**Krijoni llogari**”).
- Plotësoni të dhënat e kërkuara:
  - Email-in
  - Emrin dhe Mbiemrin
  - Numrin e telefonit
  - Numrin personal
  - Fjalëkalimin dhe konfirmimin e fjalëkalimit
- Sigurohuni që të dhënat janë të sakta dhe të plota.
- Në fund, klikoni butonin “**Krijoni llogari**” për të përfunduar regjistrimin.




The image shows a smartphone screen displaying the registration interface for 'KRU Mitrovica'. The app's logo and name are at the top. Below is a form titled 'Krijoni llogarinë tuaj!' with the following fields:

- Email:** A text input field with a placeholder 'Shkruani email-in tuaj'.
- Emri:** A text input field with a placeholder 'Shkruani emrin tuaj'.
- Mbiemri:** A text input field with a placeholder 'Shkruani mbiemrin tuaj'.
- Numri i telefonit:** A text input field with a placeholder 'Shkruani numrin e telefonit'.
- Numri personal:** A text input field with a placeholder 'Shkruani numrin personal'.
- Fjalëkalimi:** A text input field with a placeholder 'Shkruani fjalëkalimin tuaj' and a visibility toggle icon.
- Konfirmo Fjalëkalimin:** A text input field with a placeholder 'Shkruani fjalëkalimin tuaj' and a visibility toggle icon.

A large blue button at the bottom is labeled 'Krijoni llogari'.

## 2.1. Aktivizimi i llogarisë

- Pas regjistrimit, do t'ju vijë një **email për konfirmim**.
- Hapeni email-in dhe klikoni në linkun e konfirmimit.
- Pas konfirmimit, llogaria juaj do të jetë e **aktivizuar**.



## 2.1. Aktivizimi i llogarisë

- Nëse butoni për verifikim nuk funksionon, mund të klikoni linkun që do t'ju dërgohet në email.




### 3. Kyçja në sistem

Në faqen e kyçjes, përdoruesi duhet të vendosë:

- **Email-in**
- **Fjalëkalimin**


Pas plotësimit të të dhënave, klikoni butonin “**Hyr**”, për të hyrë në sistem.



## 4. Fjalëkalimi i harruar

Në rast se përdoruesi ka harruar fjalëkalimin, mund të përdorë opsionin “**Harruat fjalëkalimin?**”.

Pas vendosjes së email-it tuaj, sistemi do t’ju dërgojë një email për vendosjen e një fjalëkalimi të ri.



# 5. Shtimi i pronave

Pas hyrjes në sistem, përdoruesi dërgohet në **faqen kryesore (Dashboard)**, por meqë nuk ka asnjë pronë të regjistruar, përdoruesi duhet të regjistrojë vetë pronën e tij përmes:

- Kodit të pronës ose
- Kodit të faturës


duke klikuar **“Shto pronë”** dhe duke mbushur fushat:

- Kodi i pronës (Kodi i Klientit)
- Kodi i faturës

MITROVICA KOMPANIA RAJONALE E UJESJELLESIT SH.A REGIONAL WATER COMPANY J.S.C KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D NJI.:810364852		
TVSH	330035841	
NE:	600338033	
Kodi/Kod:	K111111	
Fatura/Racun:	F1111111	
Matesi/Merac:	8393462	
Kategoria/Kategorija:	Amvisni UM - Rurale	
Emri/Ime:	ARTAN ALIU	
Adresa:	GJON BUZUKU pr	
	8393462	
Gj. tanishme/Sad. Sta.:	2405	
Gj. paraprake/Pred. Sta.:	2405	
Diferenca/Razlika:	0	
Sherbimi:	Cmimi	Shuma
Servis	Cena	Izvos
UIT	0.5324x0.0	0

Kodi i pronës (Kodi i Klientit)


Kodi i faturës



## 6. Ballina e sistemit


Pas shtimit të pronave, përdoruesit do t'i shfaqen të dhënat kryesore të llogarisë si:

- Lart paraqitet profili i përdoruesit me njoftime dhe opsione
- Poshtë shfaqet prona me: emrin, adresën dhe borxhin aktual
- Në qendër paraqitet fatura e fundit me: shumën, afatin, borxhin total dhe butonin “**Paguaj tani**”
- Seksioni “**Transaksionet**” përfshin listën e pagesave/faturave me detaje dhe filtrim (Të gjitha, Faturat, Pagesat)
- Poshtë ndodhet menuja e navigimit:
  - **Ballina,**
  - **Pagesa,**
  - **Transaksionet**




# 6.1. Grafiku i Përdorimit dhe Kostos

Në vijim paraqitet një grafik që tregon përdorimin e ujit dhe kostot për secilin muaj, duke mundësuar një pasqyrë të qartë të shpenzimeve gjatë vitit.




## 6.2. Tabela e Transaksioneve

Ky seksion paraqet **katër faturat ose pagesat e fundit** të përdoruesit, me detaje kryesore për secilin transaksion dhe mundësinë për të parë informacion shtesë përmes klikimit në fushën e faturës.




## 6.2.1. Detajet e Transaksioneve

Kur përdoruesi klikon fushën e një transaksioni të llojit “Faturë”, hapet një dritare ku paraqiten informacionet e detajuara të faturës, si gjendja aktuale dhe paraprake e matësit, dallimi në m<sup>3</sup>, data, kodi i matësit dhe shuma totale për pagesë.




## 6.3. Transaksionet –Faturat

Për të parë vetëm Faturat nga faqja kryesore, klikoni fushën “**Faturat**” nga menyja e transaksioneve.




## 6.4. Transaksionet –Pagesat

Për të parë vetëm Pagesat nga faqja kryesore, klikoni fushën “Pagesat” nga menyja e transaksioneve.




# 7. Menuja e Transaksioneve

Për të parë të gjitha transaksionet për një pronë, përdoruesi së pari duhet të zgjedhë pronën përmes kartelave në faqen kryesore, pastaj të klikojë fushën **“Transaksionet”** në menynë e poshtme të navigimit, në anën e majtë.



# 7.1. Transaksionet


- Në këtë faqe paraqitet historia e faturimit dhe pagesave për pronën e zgjedhur
- Lart shfaqet prona me: emrin, numrin, adresën, borxhin dhe butonin **“Paguaj tani”**
- Më poshtë lista e transaksioneve (pagesa dhe fatura) me detaje:
  - Lloji i transaksionit,
  - data,
  - shuma,
  - referenca
- Mundësohet filtrimi sipas:
  - Të gjitha,
  - Faturat,
  - Pagesat
- Mund të klikoni **“Shfaq të gjitha”** për t’i shfaqur të gjitha transaksionet.



# 8. Pagesa online


Për të paguar një faturë:

- Përdoruesi duhet fillimisht të **selekttojë pronën** për të cilën dëshiron të kryejë pagesën, duke klikuar mbi **kartelën e pronës** në pjesën e sipërme të faqes.
- Pasi prona të zgjidhet, ajo do të paraqitet si **e selektuar**, duke treguar se të dhënat dhe faturat më poshtë i përkasin asaj prone.
- Më pas, përdoruesi duhet të shikojë pjesën ku paraqitet **fatura e fundit**.
- Klikoni butonin **“Paguaj tani”** për të vazhduar me procesin e pagesës.
- Pas këtij veprimi, përdoruesi dërgohet në hapat e mëtejshme për **përfundimin e pagesës së faturës** për pronën e zgjedhur.



# 8.1. Zgjedhja e shumës për pagesë

- Për të zgjedhur shumën për një pagesë:
- Përdoruesi duhet fillimisht të **zgjedhë shumën për pagesë** duke:
  - E shkruar manualisht në fushën përkatëse, ose
  - Përzgjedhur një nga opsionet e gatshme
- Pas përzgjedhjes së shumës, klikoni butonin **“Vazhdo te Pagesa”**.
- Me këtë veprim, përdoruesi vazhdon me **përfundimin e procesit të pagesës**.



## 8.2. Procesi i verifikimit të llogarisë bankare

Në përfundim të procesit të pagesës, përdoruesi duhet të shkruajë të dhënat e kartelës bankare të tij, përfshirë emrin dhe mbiemrin, numrin e kartelës, datën e skadencës dhe kodin CVV/CVC, dhe më pas të klikojë butonin **“Paguaj”** për të përfunduar pagesën.



The image shows a smartphone screen displaying a payment confirmation page. The page is titled "Paguj" (Pay) and features a dark blue header with a back arrow, a notification bell, and a settings gear. The main content is divided into two sections: "Të dhënat mbi blerjen" (Purchase details) and "Të dhënat mbi kartelën" (Card details). The purchase details section includes the merchant name "Tregtari KUR MITROVICA SH A", the website "Uebfaqja www.kru-mitrovica.com", and the amount "Shuma 13.20 EUR". The card details section includes a field for the cardholder's name "Emri dhe Mbiemri i kartelëmbajtësit", a field for the card number "Numri i kartelës" (displaying "XXXX XXXX XXXX XXXX"), a field for the expiration date "Data e skadencës" (displaying "MM/YY"), and a field for the CVV/CVC2 code (displaying "XXX"). A blue "Paguj" button is located at the bottom of the screen.

3:49 90

Paguaj

Të dhënat mbi blerjen

Tregtari  
KUR MITROVICA SH A

Uebfaqja  
www.kru-mitrovica.com

Shuma  
13.20 EUR

Të dhënat mbi kartelën

Emri dhe Mbiemri i kartelëmbajtësit

Emri dhe Mbiemri

Numri i kartelës

XXXX XXXX XXXX XXXX

Data e skadencës

MM/YY


CVV2/CVC2 ⓘ

XXX

Paguaj

# 9. Njoftimet


Për të naviguar te njoftimet, klikoni ikonën e njoftimeve në anën e djathtë të pjesës së sipërme të ekranit.



# 9.1. Faqja e Njoftimeve


Ky seksion paraqet njoftimet e përdoruesit, duke përfshirë informacione të rëndësishme si pagesat, faturat dhe mirëmbajtjet e planifikuara.

Çdo njoftim përmban titullin, përshkrimin dhe datën përkatëse, duke i mundësuar përdoruesit të jetë i informuar në kohë reale.




# 10. Cilësimet

Për të ndryshuar cilësimet e llogarisë, nga faqja kryesore klikoni në ikonën “**Cilësimet**” nga menuja përkatëse.




# 10.1. Ballina e Cilësimeve

Ky seksion paraqet cilësimet e përdoruesit, duke përfshirë menaxhimin e profilit, gjuhës dhe sigurisë së llogarisë. Përdoruesi mund të përditësojë të dhënat personale, të ndryshojë fjalëkalimin, të menaxhojë pronat dhe të dalë nga aplikacioni.




## 10.2. Gjuha

Në këtë seksion mund të zgjidhni gjuhën e aplikacionit dhe pasi të bëni ndryshimet, ato do të ruhen automatikisht.




## 10.3. Profili

Pasi të klikoni fushën me emër **“Profili”** mund të ndryshoni të dhënat tuaja personale (duke klikuar ikonën blu), si emri, mbiemri dhe numri i telefonit; dhe të vendosni ose ndryshoni fotografinë e profilit. Pas ndryshimeve, klikoni **“Ruaj”** për t’i ruajtur.




# 10.4. Ndrysho Fjalëkalimin

Në këtë seksion mund të ndryshoni fjalëkalimin tuaj duke shkruar fjalëkalimin aktual dhe duke e përsëritur atë dy herë. Në fund, klikoni butonin **“Ruaj Fjalëkalimin”**.



## 10.5. Menaxho pronat

Në këtë seksion shfaqen pronat tuaja të regjistruara, ku mund të shihni të dhënat e tyre, të shtoni pronë të re përmes butonit **“Shto pronë”**, ose të fshini një pronë ekzistuese përmes butonit të kuq në të djathtë.



## 10.6. Çkyçja nga sistemi

Për t'u çkyçur nga sistemi, përdoruesi duhet të navigojë në pjesën e poshtme të menysë së cilësimeve dhe të klikojë në opsionin “**Shkyçu**”.

